



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/58

Datë: 11 / 7 / 2017

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, bazuar në nenin 23, paragrafi 1.2 që ndërlidhet me nenin 14 paragrafi 3, alinea 3.4 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 11.07.2017, mori:

VENDIM

- I. Këshillave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës iu delegohen kompetencat për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime.
- II. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm do të bëhet në përputhje me kushtet e konkursit dhe rregullativen përkatëse në fuqi e cila do të nxjerret dhe miratohet nga Senati i Universitetit të Prishtinës.
- III. Dekanët e njësive akademike autorizohen që në emër të Këshillit të fakultetit përkatës, ti nënshruajnë vendimet për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe vendimet për pushime të lehonisë për personelin akademik të njësisë përkatëse akademike.
- IV. Dekanët e njësive akademike në përputhje me paragrafin 2 të nenit 72 të statutit autorizohen që të përfaqësojnë Universitetin në emër të fakultetit për çështjet ligjore që kanë të bëjnë me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
- V. Delegimi i kompetencave tek dekanët e njësive akademike do të përcillet edhe me përgjegjësi ligjore dhe llogaridhënie pranë organeve kompetente të Universitetit të Prishtinës dhe organeve tjera ligjore.
- VI. Rektori i Universitetit në bazë të vendimeve të këshillave të njësive akademike, do ti nënshkruaj kontratat për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës në kuadër të kompetencave statutare gëzon të drejten e nxjerrjes së rregullores për delegim të kompetencave për mjetet dhe çështjet e tjera administrative tek njësitë akademike të Universitetit. Mirëpo duke pasur parasysh nevojën për rregullimin e kësaj çështje para se të shpallet konkursi për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe faktin se hartimi i rregullores përkatëse për delegimin e kompetencave nga organet qendrore të UP-së tek njësitë akademike kërkon kohë më të gjatë angazhimi, Këshilli Drejtues konsideroi se deri në hartim të rregullores përkatëse, çështjen e delegimit të kompetencave përkohësisht ta rregulloj me vendim. Duke pasur parasysh argumentet e sipërhënuara Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Prof. dr. Ismet Salihu

Kryesues i Këshillit Drejtues

Ky vendim t'ri dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së
2. Rektorit të UP-së,
3. Senatit,
4. Dekanëve të njësive akademike,
5. Këshillave të njësive akademike,
6. Zvrës për çështie akademike.